



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 09 Janar 2023

Nr: 4

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. KLEO HEKURAN MURATAJ KANDIDAT PËR DEPUTET I
PROPOZUAR NGA PARTIA SOCIAL DEMOKRATE E SHQIPËRISË, QARKU TIRANË**

Sot më datë 09.01.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Z. Kleo Hekuran Murataj, kandidat i propozuar për deputet nga Partia Social Demokrate e Shqipërisë, qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Kleo Hekuran Murataj, kandidat i propozuar për deputet nga Partia Social Demokrate e Shqipërisë, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Data: 09 Janar 2023 Nr: 4
Ora:11:30



Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Kleo Hekuran Murataj, kandidat për deputet i Partisë Social Demokrate të Shqipërisë

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe "Kandidati për deputet".

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Kleo Hekuran Murataj, kandidat për deputet i Partisë Social Demokratike të Shqipërisë, qarku Tiranë, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr.1783 unik.

Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Partia Social Demokratike e Shqipërisë, në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin "prima facie" dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.2191 prot, datë 17.03 2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 2191/1, prot, datë 17.03.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për Deputet z. Kleo Hekuran Murataj, sipas vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr.17 të datës 16.03.2021, rezulton se: Me vendimin nr. 129, datë 21.03.1991, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar fajtor për veprën penale të Armëmbajtjes pa leje. Në bazë të nenit 224 Kodi Penal, Z. Kleo Hekuran Murataj dënohet me 3 (tre) muaj riedukim nëpërmjet punës si dhe ndalimin në masën 1/6 e pagës. Gjithashtu në vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore rezulton se z. Kleo Hekuran Murataj është rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2211 prot, datë 17.03 2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 2211/1 prot, datë 09.04.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për Deputet z. Kleo Hekuran Murataj, rezulton të ketë ndryshuar mbiemrin familjarisht nga Murataj në Murataj, pa vendim gjykatë.

Pas verifikimeve të mësipërme Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.157 datë 17.03.2021, vendosi: "Miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Social Demokratike të Shqipërisë, për qarkun Tiranë për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021".

II.

Data: 09 Janar 2023 Nr: 4
Ora: 11:30



Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Kleo Hekuran Murataj, kandidat për deputet i Partisë Social Demokratike të Shqipërisë

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Kleo Hekuran Murataj.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Kleo Hekuran Murataj, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III “TË DHËNA MBI GJËNDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”
- 1. Pyetjes 1. “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqsor të formës së prerë nga një autoritet shqiptar ose i huaj? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “ Po”duke deklaruar se:
“Është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tiranë me vendimin me nr. 129, datë 21.03.1991, nuk e mbaj mend saktë nenin, për shkak se ka kaluar shumë kohë. Për këtë arsye jam drejtuar Arkivit të gjykatës për të marrë një kopje të vendimit. Nuk e mbaj mend llojin e veprës penale , për shkak se ka kaluar shumë kohë.”
- 2. Pyetjes 3 “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose në gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po”duke deklaruar se: “Me rezerva mendoj se ka qënë policia e Hannoverit, qyteti Hannover. Nuk më kujtohet arsyeja, pasi ka kaluar shumë kohë dhe nuk mundem të them arsyen e saktë. Nuk më kujtohet data dhe muaji i saktë, por vetëm viti 2016 .Mbas shoqërimit më lanë të lirë dhe nuk jam thërritur më në dijeninë time.”
- 3. Pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese,për kryerjen e ndonjë vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po”duke deklaruar se:
 - a) Nuk më kujtohet saktë pasi ka kaluar shume kohë, Policia e Shetit,Tiranë. Arsyet nuk më kujtohet pasi ka kaluar shumë kohë dhe nuk mund të them arsyen.I jam drejtuar Gjykatës me kërkesë për kopjen e vendimit.Data nuk me kujtohet saktë pasi ka kaluar shumë kohë, fillim viti 1991. Dënuar me vendimn nr.129,datë 21.03.1991, i jam drejtuar Arkivit të gjykatës për të marrë kopjen e vendimit.
 - b) Me rezerva mendoj se ka qënë policia e Hannoverit, qyteti Hannover. Nuk më kujtohet arsyeja, pasi ka kaluar shumë kohë dhe nuk mundem të them arsyen e saktë. Nuk më kujtohet data dhe muaji i saktë, por vetëm viti 2016. Mbas shoqërimit më lanë të lirë dhe nuk jam thërritur më në dijeninë time.
- 4. Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po”duke deklaruar se:
 - a) Me sa më kujtohet pasi ka kaluar shumë kohë në periudhën 1992-1995, kam qëndruar në Athinë Greqi, si emigrant ekonomik.
 - b) Me sa më kujtohet pasi ka kaluar shumë kohë në periudhën shkurt 2016 deri në 2 prill 2016, kam qëndruar në Gjermani, për arsye biznesi.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2439 prot., datë 22.03.2021, vendosi t’ia kalojë rastin për

verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 514/59 prot., datë 23.12.2022, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Kleo Hekuran Murataj, Prokuroria e Përgjithshme pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Kleo Hekuran Murataj, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezultoi të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të padeklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;
- Rezulton që ka qënë në hetim në funksion të procedimit penal nr. 159, datë 16.02.1991, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprën penale “ Armëmbajtje pa leje” të parashikuar nga neni 224 i Kodit Penal i vitit 1977. Procedimi penal është dërguar për gjykim;
- Rezulton i dënuar me Vendimin nr.129, datë 21.03.1991, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim të formës së prerë, për veprën penale “Armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga neni 224 i Kodit Penal të kohës, me 2 (dy) muaj riedukim nëpërmjet punës duke ju ndaluar 1/6 e pagës.
- Nuk rezuton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjydhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezulton të ketë qënë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerje të një vepre penale;
- Nuk rezulton që ndaj tij të jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
- Nuk rezulton të jetë dëbuar nga territori i ndonjë shteti të huaj.

Gjithashtu, në mungesë të një përgjigje shteruese nga Zyra Federale e drejtësisë në Gjermani dhe pamundësisë për të marrë një përgjigje të tillë, pasi janë konsumuar të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore, vendimarrja bazohet në verifikimet e bëra nëpërmjet institucioneve të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Nisur nga verifikimet e mësipërme rezulton se, kandidati për deputet i subjektit politik, Partia Social Demokrate e Shqipërisë qarku Tiranë, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 409, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021. Partia Social Demokrate e Shqipërisë ka fituar 1 (një) mandat dhe z. Kleo Hekuran Murataj, kandidat i listës shumëmemërore të Partisë Social Demokrate të Shqipërisë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, qarku Tiranë, nuk ka marrë mandatin e deputetit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Kleo Hekuran Murataj, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Partia Social Demokrate e Shqipërisë, qarku Tiranë nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të deputetit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI